



Public Organization
for Local Initiatives and Supports
POLIS

Activity supported by the
Canada Fund for Local Initiatives

Activité réalisée avec l'appui du
Fonds canadien d'initiatives locales

Canada



TË DREJTAT E GRAVE NË PRONË

Legjislacioni

VS

Zbatimi në praktikë



E drejta e autorit © 2017. Organizata POLIS. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të fragmenteve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe kontrollimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në sistem ku mund të përdoret serish, apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet, inçizohet apo tjera, pa lejen paraprake të POLIS.

Raporti i përgatitur nga:

Organizata POLIS, Shkurt 2017

Ky projekt / aktivitet është financuar nga Fondi i Kanadasë për Iniciativa Lokale (CFLI) - një iniciativë e Qeverisë së Kanadasë, dhe është implementuar nga organizata POLIS.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Fondit të Kanadasë për Iniciativa Lokale (CFLI). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e organizatës POLIS dhe nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Qeverisë së Kanadasë.

Shkurtesa

ABGJ Agjencia për Barazi Gjinore

AKK Agjencia Kadastrale e Kosovës

Udhëzimi Administrativ për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga Zyrat Kadastrale Komunale

CEDAW Konventa për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas

UA Nr. 03/2016 Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve

UAZLK Udhëzimi Administrativ për Zbatimin e Ligjit për Kadastër

UATN Udhëzimi Administrativ për Tarifat Noteriale

RDPP Regjistri i të Drejtave të Pronës së Paluajtshme

KRK Kushtetuta e Republikës së Kosovës

LBGJ Ligji për Barazi Gjinore

LF Ligji për Familjen

LT Ligji për Trashëgiminë

LPJ Ligji për Procedurën Jokontestimore

LN Ligji për Noterinë

LPDTS Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore

ZKK Zyra Kadastrale Komunale

ZKGJC Zyra Komunale e Gjendjes Civile

Përkufizime

“Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit; Të zotuar që Kosova të jetë shtet i mirëqenies ekonomike” Kushtetuta e Republikës së Kosovës¹

Neni 3 [Barazia para Ligjit] 1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. 2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranura ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 7 [Vlerat] 1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut. - 3 - 2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

(5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

Neni 24 [Barazia para Ligjit] 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të

¹ <http://ëëë.mkr-ks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes] 1. Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin. 2. Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve. 3. Familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj.

Neni 71 [Kualifikimet dhe Barazia Gjinore] 1. Secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë (18) vjeç ose më i madh dhe përmbush kriteret ligjore, mund të jetë kandidat për deputet. 2. Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektoj parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuar në pajtim me parimet ndërkombëtare.

Konventa CEDAË- Neni 3 Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, duke përfshirë edhe legjislacionin, për të siguruar zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave me qëllim që t'u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut mbi bazën e barazisë me burrat.

Përmbajtja

Përkufizime	4
Përmbledhje ekzekutive.....	7
1. Hyrje	8
A. PJESA E PARË	9
2. Metodologjia.....	9
3. Korniza ligjore dhe institucionale.....	10
4. Korniza Institucionale - Institucionet përgjegjëse.....	12
5. Gjendja e regjistrimit të pronës në kontekstin gjinor në Kosovë	13
5.1. Regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve	14
5.2. Të dhënat për komunat e synuara.....	16
5.2.1. Prishtina	16
5.2.2. Ferizaj	17
5.2.3. Fushë Kosova	19
5.2.4. Drenasi	20
5.2.5. Lipjani	21
5.2.6. Obiliqi	22
5.2.7. Kaçaniku	23
5.2.8. Shtime	25
5.2.9. Hani i Elezit.....	26
5.2.10. Regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve në 10 Komuna dhe opinionet e qytetarëve në facebook.....	27
B. PJESA E DYTË	31
6. Metodologjia dhe informata demografike	31
7. Gjetjet nga intervistat me akterë.....	32
7.1. Gjetjet nga Intervistat me zyrtarë public	32
7.2. Gjetjet nga intervistat me noterët	38
7.3. Gjetjet nga zyrtarët kadastral	41
7.4. Gjetjet nga zyrtarët për barazi gjinore dhe grupet e grave asambleiste	44
8. Përmbledhje nga të gjitha intervistat	45
9. Të gjeturat e përtgjithshme	47
10. Konkluzione.....	48
11. Rekomandime	50
12. Referencat.....	51

Përmbledhje ekzekutive

Koncepti dhe qëllimi i këtij raporti lidhet me kornizen analitike të legjislacionit primar dhe sekondar në Kosovë që garantojnë të drejta të barabarta për të dy gjinitë, masa shtesë për avancimin e politikave ligjore në politika operacionale duke përdorë masa të diskriminimit pozitiv dhe atë afirmativ me kohë të caktuar, që kultura zakonore, kultura institucionale dhe drejtësia gjinore të vihen në vend.

Përderisa çështjet gjinore dhe konceptet gjinore kërkojnë kohë në ndryshim të të menduarit dhe kuptimit dhe trajtimit multidimensional, dhe përkundër faktit se gjithë këto masa dhe detyrime ligjore që burojnë nga akti më i lartë Kushtetuta e Republikës së Kosovës për t'i hapur rrugë trajtimit të barabartë në të gjitha segmentet e jetës, në praktikat ditore, regjistri dhe ndarja e pasurisë së përbashkët mes gjinive tërheqë akoma nevojën e domosdoshme që masat e tilla të jenë më afatgjate.

Jo rrallëhere Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë obligime të tilla ligjore të cilat kanë vlejtur vetëm për një vit, duke vendosur edhe Masat affirmative si një lloj garancie shtesë që përveç ligjeve dhe akteve ligjore shteti, bënë edhe një hap për realizim të barazisë mes burrave dhe grave, edhe në prone edhe në punësim. Por të dhënat e këtij raporti nuk e tregojnë gjendjen e mirë edhe pse shihet një vullnet dhe gatishmëri e Agjenciave dhe zyrave përkatëse për të eliminuar barrierat ligjore dhe zakonore në ndarje të drejtë dhe të barabartë të pronës.

Gjinia si term vazhdon të ballafaqohet si çështje e gruas dhe e grave në përgjithësi. Në raportin tonë gjinia është ndarë si gra dhe burra duke dashur që këtë koncept t'a përdorim konform regjistrave zyrtare duke iu referuar personave juridik dhe atyre fizik.

Prandaj, derisa flitet për gjininë, mundësitë e barabarta, masat e marra nga shteti thërrasin për një rend të ri ligjor, për edukim dhe informim të vazhdueshëm përmes këtyre masave, detyrim për vënien e drejtësisë gjinore dhe atë derisa kjo të arrihet në shkallën e garantuar me kushtetutë dhe ligje në fuqi.

Duke iu referuar mëtutje historikut të zhvillimit të shoqërisë në Kosovë, 17-të vjet pas luftës akoma mbetet në fuqi e drejta zakonore sa i përket të drejtës së trashëgimisë. Deri në vitet e pasluftës, në shoqëri ka pas pak ose fare raste të të drejtës së gruas në pronë, për faktin se mbizotërimi i kanunit ka qenë ombrellë e njohurisë qytetare për pronën. Në vitin 2003, me hartimin e ligjit për familjen dhe kodit civil të Kosovës, dispozitat e vëna në ligj kanë marrë

parasyshtë të gjitha aktet ndërkombëtare që do të avancojnë të drejtën e gruas ² e veçanërisht Konevntën CEDAË e cila është pjesë edhe e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

1. Hyrje

Qëllimi i këtij raporti është prezantimi e opinionit të një shtrese të caktuar të shoqërisë, sikur janë zyrtarët e ndryshëm që veprojnë në nivelin lokal, e që në një formë janë të lidhur me çështjet dhe të drejtat pronësore në Kosovë. Pjesë tjetër e veçant e këtij raporti është edhe vlerësimi apo matja e nivelit të zbatimit të Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve të miratuar nga Qeveria e Kosovës në mars të vitit 2016. Si dhe në fund të ofroj disa përfundime të bazuara rreth gjendjes së të drejtave të grave në pronë, rekomandime eventuale që mund të shpiejnë në një avancim të të drejtave dhe pozitës së grave në pronë.

Qëllimi i këtij raporti është të japë një vlerësim të jashtëm, në kuptim të vlerësimit që do të bëjnë institucionet përkatëse zbatuese të Udhëzimit Administrativ. Në fakt ky vlerësim është i paraqitur me një pasqyrim të procesit dhe zbatimit të këtij udhëzimi në 10 komuna që kanë qenë target të këtij projekti. Komunat targetuara në këtë projekt janë pesë nga regjioni i Prishtinës (Komunat Prishtina, Lipjani, Obiliqi, Fushë Kosova dhe Drenasi) dhe pesë nga Regjioni i Ferizajt (Ferizaj, Shtime, Kaçanaik, Hani i Elezit dhe Shtërpçë. Arsyeja e përzgjedhjes së këtyre komunave, është e ndërlidhur me mbulueshmërinë gjeografike që ka në orinetimet strategjike POLIS.

Të dhënat që do të gjenden në këtë raport përfshijnë një qasje shumëdimensionale të adresimit të çështjeve, sfidave dhe nevojave për ndërhyrje që ndërlidhen me të drejtat e grave në pronë. Gjithashtu ky raport do të adresoj qëndrimet nga zyrtarë të ndryshëm kompetent për të drejtat e grave në pronë. Duke marrë parasyshtë edhe bazën ligjore dhe politikat institucionale me qëllim që çështjet e ndërlidhura të adresohen tek institucionet përgjegjëse.

² Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] 1 Ligji për trashëgiminë, nën titullin “Barazia në trashëgimi”, përcakton në nenin 3.1 se: “Të gjithë personat fizik në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi”.

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

Të dhanat e paraqitura në këtë raport janë të karakterit sasior, përkatsisht statistikore të cilat na kanë ndihmuar që të bëjmë një vlerësim sa më real të zbatimit të këtij Udhëzimi, por në një formë të masim edhe ndikimin e masave nga udhëzim në rritjen a po zvoglimin e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Veç, të dhënave statistikore, jnë këtë raport gjenden edhe të dhëna kualitative të nxjerruara përmes intervistimit me zyrtarë publik nga komunat e targetuara. Kur, i analizojmë këto dy lloj të dhënash vijmë në disa përfudnime që të drejtat pronësore në Kosovë, dhe zbatimi praktikë i këtyre të drejtave në veçanti për gratë, mbetet bukur e sfidueshme.

Nisur nga ky konstatim, pjesë e këtij projekti ka qenë edhe aktiviteti informues në lidhje me mundësitë dhe lehtësirat e krijuara për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve sipas masave afirmative të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ 03/2016. Aktiviteti i tillë ka përfshirë shpërndarje të materialit vetëdijësues në komunat që kanë qenë pjesë e projektit, si dhe publikim TV klipit në televione lokale.

A. PJESA E PARË

2. Metodologjia

Metodologjia e këtij hulumtimi është e përqendruar në spektrin e metodave dhe të qasjeve kuantitative dhe empirike, me qëllim të operacionalizimit të detyrimeve me qëllim dhe funksion afirmativ në zbatim të udhëzimit administrativ të qeverisë dhe si segmente që mund të gjurmohen dhe të reflektohen në rezultate dobiprurëse, të përdorura në mënyrë kritike, analitike për finalizimin e të gjeturave, krijimin e hapsirave dhe lehtësimeve për të mirën e përgjithshme.

Duke qenë që ky raport përmabnë të dhëna empirike si dhe të dhëna tjera kauntitive, atëherë metodologjia e përdorur është e dy llojshme. Për të dhënat empirike apo kualitative janë përdorur dy lloj metodash të matjes së opinionit. Njëra përfshinë intervistat me zyrtarët kompetent për të zbatim të këtij udhëzimi, dhe tjetra përfshinë anketimet me zyrtarët e ndryshëm të nivelit komunal për të matur opinionin e tyre kundrejt të drejtave të grave në pronë, nivelin e informimit dhe zbatimit të këtij udhëzimi, si mendimin e tyre lidhur me të drejtat e grave në pronë. Derisa, për të dhënat statisikore, si proces i vlerësimit të zbatimit dhe efektit të arritur përmes masave afirmative janë mbledhur të dhëna nga zyrat kadastrale komunale dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Ky hulumtim është realizuar edhe me qasje empirike të bazuar ë përvojë dhe në mbështetje me të kaluarën dhe nxjerrjen e konkluzioneve e gjykimeve si mjaft të rëndësishme, si gjetje indikative të realitetit në Kosovë sa i përket të drejtës së gruas në pronë duke marrë gjithmonë për bazë ligjet të cilat e rregullojnë fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtën e trajtimit të barabartë mes dy gjinive.

3. Korniza ligjore dhe institucionale

“Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit; Të zotuar që Kosova të jetë shtet i mirëqenies ekonomike” Kushtetuta e Republikës së Kosovës³

Korniza ligjore që rregullon fushën e të drejtave pronësore në Kosovë është mjaftë e avancuar. Kjo përbëhet nga një mori ligjesh që i japin të drejtë dhe mundësi të barabarta të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa ndonjë dallim përkatësie sociale, etnike, gjinore apo tjetër. Në këtë rrafsh edhe çështja e të drejtave të grave në pronë, e drejta për posedim të pronës dhe shfrytëzim të saj është e garantuar. Disa prej ligjeve që rregullojnë fushën e të drejtave të grave dhe burrave në përgjithësi janë: Ligji për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore; Ligji për familjen, Ligji për trashëgiminë e kështu me radhë.

Në lidhje me të drejtat e grave në pronë vlenë të cekën disa klauzola të ligjit mbi familjen dhe ligjit mbi trashëgiminë. Këto ligje rregullojnë të drejtëne grave në pronën e krijuar në bashkëshortësi (martesë) si të drejtën e grave në pronën dhe pasurinë e trashëguar. Ligji mbi familjen në Nenin 47 dhe Nenin 50, specifikon të drejtën e barabartë të gruas dhe burrit në pronën e krijuar gjatë periudhës martesore. Kështu Neni 47, Pika 1, thotë se “Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si

³ <http://ëëë.mkr-ks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë”. Ndërsa Neni 50 Pika 1 e po këtij ligi, specifikon se “të drejtat e bashkëshortëve për sendet e paluajtshme, të cilat janë pasuri e tyre e përbashkët, ashtu siç parashihet në nenin 47 të këtij Ligji, regjistrohen në Regjistrin publik të pasurive të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët në pjesë të papërcaktuara”. Kjo rregullativë ligjore e njehë plotësisht të drejtën e barabartë të grave në pronën e paluajtshme dhe pasurinë e krijuar në formë të përbashkët në bashkëshortësi.

Ajo që mbetet jë mangësi e thekësuar në lidhje me të drejtën e grave në pronën përbashkët bashkëshortore është regjistrimi i pronës në emër të të dy bashkëshortëve. Kjo vërehet nga të gjitha të dhënat e disponueshme nga autoritetet publike kompetente të fushës së regjistrimit të pronës. Ligji mbi familjen në Nenin 50, Pika 2, bënë një specifikim shumë të qartë edhe të kësaj çështjeje. Aty thuhet se “kur vetëm njëri prej bashkëshortëve regjistrohet si bartës i së drejtës pronësore për pasurinë e përbashkët në regjistrin e të drejtave në pasuri të patundshme, do të konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të të dy bashkëshortëve. Pasuria nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve, ashtu siç është përcaktuar me ligjin në fuqi”. Pra, sipas këtij legjislacioni edhe pse vetëm njëri prej bashkëshortëve mundet të ketë të regjistruar pronën e përbashkët në emrin e tij, e drejta e bashkëshortit tjetër është tërësisht e barabart, sikur të jetë prona e regjistruar edhe në emër të tij. Megjithkëtë, praktika tregon se kjo e drejtë nuk është e shfrytëzuar në mënyrë të balancuar nga të dy gjinitë. Është bashkëshorti (burri) ai që zakonisht bënë regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të tij, natyrisht me pëlqimin e bashkëshortes sikur e kërkon legjislacioni.

Në lidhje me pëlqimin e bashkëshortit/es për tjetërsimin e një prone të përbashkët bashkëshortore, ekzistojnë të dhëna se kjo ndonjëherë është keqpërdorur nga njëri bashkëshortë. Kjo është bërë duke mos i treguar qartë bashkëshortes për natyrën dhe qëllimin e dhënies së pëlqimit, qoftë duke keqpërdorur nënshkrimin apo firmën e saj në dokumentin e pëlqimit.

Derisa, legjislacioni e njehë të drejtën e gruas për të dhënë pronare *de facto* edhe nëse nukë është prona *de jure* e pronës së përbashkët, atëherë praktika ishte dashur që të n’a jap më shumë raste kur burri dhe gruaja e regjistrojnë pronën në emër të dyve. Pikërisht për këtë hendet faktik, shteti përmes mekanizmave të vet insititucional dhe ligjor ndërmerrë masa, të njohura si masa afirmative, për të balancuar çështje të caktuara që janë në disbalancë të thekësuar. Në lidhje me të drejtën e grave në pronë të përbashkët martesore, Qeveria e Kosovës ka nxjerrur Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 03/2016, përmes të cilit udhëzim mënjon tarifën e regjistrimit të pronës në emër të të dy bashkëshortëve në regjistrat publik. Kjo masë është përdorur për të nxitur burrat dhe gratë, që të bëjnë regjistrimin e pronës në emër

të dy bashkëshortëve, duke përfituar nga mospagesa e tarifës së regjistrimit të pronës në regjistrat publik komunal.

Masat apo veprimet e tilla janë të mirëseardhura në shoqëritë që janë në zhvillim e sipër sikur është Kosova. Megjithkëtë, duket se nevoja për masa afirmative, por të shoqëruara edhe me aktivitete tjera ndërgjegjësuëse, informuese, dhe benefite të qarta qofshin ato edhe materiale (sikur janë subvencionet e ndryshme) është ende evidente. Ky konstatim është krijuar gjatë procesit të vlerësimit të zbatimit të këtij udhëzimi, në komunat të cilat kanë qenë në fokus të vëzhgimit dhe mbledhjes së të dhënave.

Të dhënat më të detalizuara dhe më analitike, qoftë të gjendjes së gruas në pjesëmarrjen e saj në pronë, qoftë në regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve, para dhe pas këtij udhëzimi do të jepen në pjesët e veçanta më këtë raport.

4. Korniza Institucionale - Institucionet përgjegjëse

Janë një mori insititucionesh që janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit që kanë të bëjnë me të drejtat e grave në pronë, apo edhe në sfera të tjera të jetës dhe shoqërore. Për relevancën e këtij raporti, është me rëndësi të specifikohen disa prej institucioneve që janë të ndërlidhura direkt me sferën e regjistrimit të pronës në emër të gruas, qoftë ajo pronë e krijuar në martesë, me trashëgimi, dhuratë apo pronë individuale. Kështu, institucionet që janë përgjegjëse, por në një formë kanë edhe ndikim në avancimin e pozitës së gruas në pronë, janë Agjencia për Barazi Gjinore së bashku me zyrtarët për barazi gjinore në institucione tjera qendore dhe lokale; Agjencia Kadastrale së bashku me zyrtarët kadastrale komunale; Noteritë, Gjykatat, Zyrtarët e Gjendjes Civile e kështu me radhë.

Agjencia për Barazi Gjinore është përgjegjëse për promovim të barazisë gjinore, duke përcjellur zbatimin e legjislacionit, por edhe duke propozuar masa që stimulojnë barazinë gjinore në jetën publike dhe në pronë. Ndërlidhur me këtë fushëveprimtari, veprojnë edhe Zyrtarët për Barazi Gjinore në institucionet qendore dhe në komuna. Këto, dy organe me detyra të veçanta në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre masave, sidomos masat nga Udhëzimi Administrativ 03/2016.

Agjencia Kadastrale e Kosovës është po ashtu një organ përgjegjës për mbikëqyrje të zbatimit të Udhëzimit Administrative 03/2016, derisa Zyrtarët Kadastrale Komunale poa shtu janë përgjegjëse për zbatim të masave afirmative nga ky udhëzim.

Një organ tjetër shumë i rëndësishëm në lidhje me zbatimin e drejtëpërdrejtë të të drejtave të grave në pronën e përbashkët janë Noteritë. Zyrat noteriale janë përgjegjëse për zbatimin masave të dalura nga udhëzimi administrativ, duke e zbatuar kërkesat ligjore nga legjislacioni mbi familjen dhe trashëgiminë, por edhe kushtet që dalin nga udhëzimi administrativ.


Kur të e analizojmë më poshtë situatën e krijuar mbi të drejtat dhe pjesëmarrjen e grave në pronën e përbashkët, pas hyrjes në fuqi të masave afirmative, mund të vërejmë se ekziston një hendek në mes mundësisë së krijuar përmes legjislacionit, dhe realizimit faktik në praktikë. Duket kjo situatë ka një emërues të përbashkët për të gjitha këto institucione. Nevoja për një koordinim më të madh në zbatimin, promovimin dhe raportimin e aktiviteteve nga të gjitha këto institucione në lidhje me këto masa. Dhe nevoja për më shumë aktivitete ndërgjegjësues dhe informues për përfitimet nga këto masa afirmative.

5. Gjendja e regjistrimit të pronës në kontekstin gjinor në Kosovë

Për të pasqyruar gjendjen e gruas në regjistrim të pronës në emër të dy bashkëshortëve, por edhe të pjesëmarrjes së gruas si pronare në pronë të trashëguar, të dhuruar apo të blerë në mënyrë individuale, kemi mbledhur të dhëna nga Agjencia Kadastrale dhe Zyrat Komunale Kadastrale. Këto dhëna janë më së relevante për të e treguar mirëfilli pozitën e gruas në shoqëri nga ky kontekst i pronës. Dhe në veçanti ndryshimin pozitiv apo jo pozitiv të kësaj situatë pas hyrjes në fuqi të masave të përkohëshme afirmative sipas udhëzimit të lartëcekur.

Të dhënat e disponueshme janë për disa komuna të regjionit të Prishtinës dhe Ferizajt me një krahasim nga viti 2015 dhe 2016. Duke ditur që udhëzimi ka hyrë në fuqi në mars 2016, atëherë është shumë me rëndësi me pa situatën para se këto masa të vëhen në zbatim. Kjo sa i takon vetëm pjesës së regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Por, në anën janë edhe të dhënat tjera krahasimtare për pjesëmarrjen e përgjithshme të gruas në pronë, tregojnë se situata nuk është e kënaqshme.

Kështu të dhënat e mëposhtme tregojnë gjendjen e regjistrimit të pronës në cilindo lloj të pronave në emër të grave, për disa komuna që kemi të dhëna të disponueshme dhe në formë krahasimtare ndërmjet viteve 2015 dhe 2016. Kjo do të n'a tregoj progresin e ngadalshëm të kësaj balancit gjinor në pronë dhe ndikimin të masa afirmative, por edhe politikave të tjera nacionale që mund të kenë pasur efekt në rritjen e pjesëmarrjes së grave në pronë.



Kjo grafikë n'a jep të dhëna për pozitën e gruas në pronë në nivel të dhjetë komunave, Prishtinë, Lipjan, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas, Shtime, Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit dhe Shtërpçë, për 2015 dhe 2016. Nga kjo grafikë shohim se në vitin 2015 kemi pasur pjesëmarrje të grave në nivel prej 11.13% në regjistrim apo posedim të të gjitha llojeve të pronave nga ana e grave, kundrejt 88.87% nga burrat. Derisa në vitin 2016 në po të njejta komuna, pjesëmarrja e grave shënon një rritje shumë të vogël në raport me vitin 2015. Edhe pse në vitin 2016 po ashtu ka një rritje të përgjithshme të numrit të pronave të regjistruara nga burrat dhe gratë. Pra në vitin 2016 pjesëmarrja e grave është në nivelin prej 12.12 %, kunderjt burrave prej 87.88%. Megjithatë nëse e krahasojmë me të dhënat e vitit 2015 në kuptim të numrave, atëherë n'a del që në vitin 2016 pjesëmarrja e grave në regjistrim apo posedim të pronës është për 980 raste më shumë se sa në vitin 2015. Natyrisht që kjo është një rritje solide për këto 10 komuna, e që në një formë tregon trendin pozitiv, që mund të jetë relevant edhe për nivel të Kosovës.

5.1. Regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve

Sikur është cekur më lartë, kuadri ligjor është mjaft avancues në promovimin e të drejtave të grave në pronë, por zbatimi i këtyre të drejtave të përcaktuara me ligj po hasë vazhdimisht në vështirësi. Pikërisht, për këtë ka ardhur nevoja për masa shtesë afirmative dhe nxitëse, qoftë të avancimit të të drejtave të grave, qoftë të stimulimit për zbatim të legjislacionit. Dhe, poashtu

pikërisht për shkak të ekzistimit të masave të tilla, ne do të i bëjmë edhe një vlerësim zbatimit të këtyre masave.

Sfidat e zbatimit të këtij udhëzimi ndërlidhen me disa aktivitete që janë apo nuk janë koordinuar mirëfilli në mes institucioneve gjegjëse për hartim dhe zbatim të këtyre masave. Kështu, udhëzimi administrativ ka paraparë, që tarifa e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve sipas Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2014 Për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtëshme nga zyret kadastrale komunale, e përcaktuar në Neni 5 lidhur me Regjistrimin e pronësisë, posedimi në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi dhe pronësisë, ku tarifa e regjistrimit të kësaj lloji pronësie është e përcaktuar 20 Euro. Udhëzimi Administrativ QRK Nr. 03/2016, ka vendosur që kjo lloji tarife mos të zbatohet, në rastet kur bashkëshortët e regjistron pronën si të përbashkët dhe në emër të të dyve. Praktika e komunave nga zyrat kadastrale n'a tregon se kë në zbatimin e kësaj mase ka psur një keqkuptim të thellë. Disa komuna, sikur është Prishtina dhe Drenasi kanë zbatuar këtë udhëzim duke mos e tarifuar shumën prej 20 Euro, në rastet e regjistrimeve të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Por, në anën tjetër e kanë ekzekutuar taksën e transaksionit të paluajtshmërisë. Madje, deri në muajin Maj 2016, Komuna e Prishtinës e ka zbatuar taksën e dyfishtë të transaksionit në vlerën prej 150 Euro për transaksion. Pra duke paguar të dy bashkëshortët nga 150 euro, përkatësisht 300 euro, e që në të kundërtën, nëse do të regjistronin vetëm në emër të njërit bashkëshortë, do të paguanin vetëm 150 Euro. Pra, janë liruar nga 20 Euro si tarifë e regjistrimit, dhe janë ngarkuar me 300 Euro si taksë e transaksionit. Pas muajit Maj taksa mbi transaksionin është zbatuar vetëm për njërin bashkëshortë në Komunën e Prishtinës. Në anën tjetër, në Komunën e Drenasit taksa e transaksionit ka qenë në fuqi deri në dhjetor 2016, edhe pse tarifa e regjistrimit nuk është zbatuar pas hyrjes së udhëzimit në fuqi.

Në komunat tjera e kemi një situatë tjetër. Disa komuna nuk kanë qenë fare duke e zbatuar tarifën e regjistrimit të pronës së përbashkët në vlerën prej 20 Euro. Andaj, pas hyrjes në fuqi të masave afirmative sipas udhëzimit administrativ, këto komuna si Lipjani, Fushë Kosova, Obiliqi, Shtimja, Ferizaj e të tjera, kanë zbatuar këtë udhëzim duke mënjanuar taksën e transaksionit. Kjo ka ndikuar që të ketë një efekt pozitiv si rezultat i masave nga ky udhëzim, por në anën tjetër ky udhëzim nuk i ka liruar nga taksa e transaksionit, por nga tarifa e regjistrimit.


Për të e pasur më të qartë gjendjen e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve për vitin 2015, dhe më pas për të e vlerësuar efektin e regjistrimit të pronës pas masave afirmative, do të prezentojmë këto dhëna për disa prej komunave që kanë qenë në fokus të aktivitetit tonë.

5.2. Të dhënat për komunat e synuara


Të e fillojmë me gjendjen në dy prej komunave më të mëdha që kanë qenë pjesë e projektit, njëherit si qytetet kryesore për regjionet e tyre përkatëse. Këto dy qytete na japin dy ekstreme të ndryshme që janë shumë të rëndësishme për trajtimet e më pastajshme, por njëherit shërbejnë edhe si refleksion të asaj që është vepruar me rastin e planifikimit të këtyre masave afirmative. Prishtina dhe Ferizaj janë dy qytete që tregojnë se njërin ka një lëvizje shumë pozitive në kuptim të përfshirjes së gruas në të drejtën e saj në pronë, dhe në qytetin tjetër ka një rënie drastike të numrit të rasteve kur gruaja bëhet pronare e përbashkët e pronës së krijuar në martesë.

5.2.1. Prishtina

Në grafikën e mëposhtme janë paraqitura të dhënat e regjistrimit të pronës në emër të burrave dhe grave, duke përfshirë të gjitha llojet e pronave. Nga këto të dhëna konstatohet se sa i takon pjesëmarrjes së grave dhe burrave në të drejtat e tyre pronësore në komunën e Prishtinës ka një trend pozitiv. Pra pjesëmarrja e grave vazhdon të ketë një rritje të lehtë, qoftë në kuptim të përqindjes, qoftë në terma real numerik. Kështu në vitin 2015 në Komunën e Prishtinës, kemi pasur një numër prej 439 rasteve kur gratë kanë regjistruar apo poseduar në ndonjë formë pronë në emër të tyre. Derisa në vitin 2016 ky numër është 555 raste.



Por, gjendja është shumë më keq në raport me regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve. Grafika e më poshtme e paraqet këtë situatë.



Nga kjo grafikë shohim se në Komunën e Prishtinës nga në vitin 2015 ka pasur 331 raste kur gratë dhe burrat, në cilësinë e bashkëshortëve e kanë regjistruar pronën e përbashkët në emër të të dyve. Derisa në vitin 2016 ky numër ka rënë drastikisht, më saktësisht janë vetëm 21 raste të tilla. Shkaqet janë diskutuar më sipër. Duket se njëri nga më të rëndësishmit është se ka kasur një komunikim jo të duhur në mes autoriteteve komunale dhe agjencive përkatëse për zbatim të udhëzimit. Gjithashtu edhe informimi i noterëve karshi kësaj problematike ka munguar, në drejtim të informimit të palëve. Por, më kryesore mund të jetë se komuna e ka taksuar dyfish një pronë që regjistrohet në emër të dy bashkëshortëve. Duke i detyruar palët bashkëshortor të paguajnë taksën e transaksionit, sikur të ishin dy palë të rëndësishme dhe jo çift bashkëshortor.

5.2.2. Ferizaj

Ferizaj n'a paraqet një rast tërësisht më pozitiv të regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Por në anën tjetër edhe në pjesëmarrjen e grave në pronë, është në suaza të nivelit të përgjithshëm në Kosovë. Kështu grafika e më poshtme e paraqet gjendjen e regjistrimit të pronës në të gjitha llojet e pronave.

FERIZAJ

NUMRI I PËRGJITHSHËM I PJESËMARRËSVE GRA DHE BURRA NË REGJISTRIM TË LLOJEVE TË NDRYSHME TË PRONËS NË REGJISTRAT PUBLIK

2016



2015



Të dhënat e tilla tregojnë se pjesëmarrja e grave në çështjet pronësore është në rritje në raport me vitin 2015. Në vitin 2015 janë gjithësejt 632 gra që kanë regjistruar pronë në emër të tyre, derisa në vitin 2016 janë 919 gra. E përkthyer në përqindje n'a del që në vitin 2015 pjesëmarrja e grave ka qenë vetëm 11.30%, kurse në vitin 2016 ka qenë 13.24%.

NUMRI I REGJISTRIMEVE TË PRONËS NË EMËR TË DY BASHKËSHORTËVE

2015



1

2016




304

Situatë krejtësisht më pozitive dhe një rast sukseesi në nivel të Kosovës është Ferizaj. Në këtë komunë siç edhe është paraqitur në grafikën e mësipërme, për vitin 2015 është regjistruar


vetëm një pronë në emër të dy bashkëshortëve. Një situatë tjetër dhe indikator mjaft pozitiv na paraqitet në vitin 2016, pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ për masat e veçanta, pasi që kemi rritje enorme në krahasim me vitin paraprak të regjistrimit të pronave në emër të dy bashkëshortëve, pra, janë gjithsejt 304 prona të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve. Nga këto të dhëna, vërejmë që Udhëzimi Administrativ (QRK) 03/2016 ka ndikuar pozitivisht në regjistrimin e pronës së paluajtshme e të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve.

5.2.3. Fushë Kosova

Grafika e mëposhtme paraqet për Komunën e Fushë Kosovës, numrin e përgjithshëm të pronave të regjistruara për vitin 2015 dhe vitin 2016. Sipas këtyre të dhënave del që pjesëarrja e grave në regjistrim të pronës është mbi 50% më e lartë se në vitin 2015.




Ndërsa grafika tjetër paraqet numrin e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Në bazë të të dhënave të paraqitura në këtë grafikë, në të dy vitet e kaluara është identike. Nuk është se ka pasur rritje ose zvogëlim pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ për masat e veçanta.




5.2.4. Drenasi

Në këtë komunë në vitin 2016 ka numër më të vogël të pjesëmarrjes të burrave dhe grave në regjistrim të pronave të ndryshme se sa në vitin 2015, megjithatë pjesëmarrja e grave është pakez më e lartë se sa në vitin 2015. Ky trend tregon po ashtu se çështja e grave në pronë është duke u rritur.




Grafika e mëposhtme paraqet regjistrimin e pronave në emër të dy bashkëshortëve për vitin 2015 dhe vitin 2016 në komunën e Drenasit. Në vitin 2015 është paraqitur vetëm një rast që e kanë regjistruar pronën në emër të përbashkët nga bashkëshortët. Ndërsa në vitin 2016 pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ vërejmë një rritje të lehtë, pasi që janë të regjistruara 18 prona në emër të dy bashkëshortëve.




5.2.5. Lipjani

Në grafikën e mëposhtme është paraqitur numri i përgjithshëm i personave që e kanë regjistruar pronën për vitin 2015 dhe vitin 2016. Për vitin 2015 në këtë komunë janë 155 gra të cilat kanë regjistruar pronën në emër të tyre, përkundrejt 1975 burrave që e kanë regjistruar pronën në emër të tyre. Një situatë më e mirë sa i përket regjistrimit të pronës në emër grave është paraqitur në vitin 2016, pasi që janë 241 gra që e kanë bërë regjistrimin e pronës, përkundrejt 2388 burrave.




Grafika e mëposhtme paraqet numrin e regjistrimeve të pronës në emër të dy bashkëshortëve për vitin 2015 dhe vitin 2016. Në vitin 2015 është vetëm një rast që e kanë regjistruar pronën në emër të të dy bashkëshortëve. Ndërsa situatë më e mirë edhe pse jo e kënaqshme na paraqitet në vitin 2016 pasi që janë 27 raste të reja që e kanë regjistruar pronën e tyre në emër të dy bashkëshortëve.




5.2.6. Obiliqi

Kjo grafikë e paraqitur tregon numrin e pronave që janë regjistruar përgjatë dy viteve 2015 - 2016. Janë gjithsej 1343 prona të regjistruara për vitin 2015, nga këto prona janë 164 të regjistruara në emër të grave, dhe 1179 të regjistruara në emër të burrave. Një gjendje më e mirë dhe më e favorshme në terma numërik na paraqitet në vitin pasues, pasi që nga gjithsej 2528 prona të regjistruara, 279 janë të regjistruara në emër të grave, ndërsa 2249 janë të regjistruara në emër të burrave.




Grafika e mëposhtme paraqet numrin e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve për vitin 2015 dhe vitin 2016. Nga këto të dhëna shohim se në vitin 2015 janë vetëm 3 raste që e kanë regjistruar pronën në emër të dy bashkëshortëve. Nuk është se ka rritje në vitin 2016 përkundër Udhëzimit Administrativ i cili i liron nga tarifa regjistruese bashkëshortet që e regjistrojnë pronën në emër të përbashkët, përkundrazi në këtë vit është vetëm një rast që e kanë regjistruar pronën në emër të përbashkët.




5.2.7. Kaçaniku

Në këtë grafikë paraqiten të dhënat e regjistrimit të pronave për Komunën e Kaçanikut për vitin 2015 dhe vitin 2016. Këto të dhëna janë të marra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Grafika paraqet numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve grave dhe burra në regjistrim të llojeve të ndryshme të pronës në regjistrat publik.




Në vitin 2015 janë regjistruar gjithsejt 1484 prona në këtë komunë. Nga ky numër janë vetëm 99 prona të regjistruara në emër të grave, kundrejt 1385 pronave të regjistruara në emër të burrave. Në vitin 2016 gjithsejt janë regjistruar në këtë komunë 2806 prona. Shohim një rritje të mirë të regjistrimit të pronave në emër të grave, pasi që janë 227 prona të regjistruara në emër të grave, një rritje shumë e mirë në krahasim me vitin paraprak. Ndërsa janë të regjistruara 2579 prona në emër të burrave.

Grafika e mëposhtme paraqet regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve për vitin 2015 dhe vitin 2016. Sa i përket regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve në vitin 2015 nuk ka pasur asnjë rast që e kanë regjistruar pronën në emër të dy bashkëshortëve. Një situatë tjetër na paraqitet në vitin 2016 pasi që ka hyrë në fuqi të Udhëzimit Administrativ për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve, pasi të dhënat e marra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës tregojnë një rritje në 88 të pronave të regjistruara në emër të dy përbashkët.



5.2.8. Shtime

Grafika e paraqitur tregon numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve gra dhe burra në regjistrim të llojeve të ndryshme të pronës në regjistrat publik në Komunën e Shtimes. Në vitin 2015 kemi gjithsejt 1395 prona të regjistruara në këtë komunë, nga këto prona të regjistruara janë vetëm 104 prona të regjistruara në emër të grave, ndërsa janë 1291 prona të regjistruara në emër të burrave. Një situatë shumë më e mirë se në vitin paraprak na paraqitet në vitin 2016, pasi që nga 1983 prona të regjistruara gjithsejt, janë 239 prona të regjistruara në emër të grave, ndërsa 1744 prona të regjistruara në emër të burrave. Pra shihet se është një situatë më e mirë e paraqitur në vitin e kaluar sa i përket regjistrimit të pronave në emër të grave.




Grafika e mëposhtme paraqet numrin e regjistrimit të pronave në emër të dy bashkëshortëve për vitin 2015 dhe vitin 2016. Në vitin 2015 nuk është regjistruar asnjë pronë në emër të dy bashkëshortëve, por nuk është se kemi një rritje të madhe edhe pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ lidhur me masat e veçanta, pasi që janë vetëm 8 prona të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve në vitin 2016.



5.2.9. Hani i Elezit

Grafika e paraqitur tregon gjendjen e numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve gra dhe burra në regjistrim të llojeve të ndryshme të pronës në regjistrat publik për Komunën e Hanit të Elezit. Në vitin 2015 janë regjistruar gjithsejt 382 prona, nga të cilat vetëm 60 prona janë të regjistruara në emër të grave, kundrejt 322 pronave që janë regjistruar në emër të burrave. Në vitin 2016 nuk është se ka pasur përmisim, madje ka pasur edhe ulje të numrit të regjistrimit të pronave në emër të grave. Në këtë vit janë gjithsejt 1237 prona të regjistruara në këtë komunë, dhe prej tyre vetëm 50 pronave janë të regjistruara në emër të grave, kundrejt 1187 pronave të regjistruara në emër të burrave. Shohim se këto të dhëna nuk na japin lajme të mira sa i përket regjistrimit të pronës në emër të grave.




Sa i përket regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve për vitin 2015 në këtë komunë nuk ka pasur asnjë pronë të regjistruar në emër të dy bashkëshortëve. Në vitin 2016 janë 4 prona të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve, pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ (QRK) 03/2016.



5.2.10. Regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve në 10 Komuna dhe opinionet e qytetarëve në facebook

Në këtë pjesë paraqitet një grafikë e përmbledhur që trego nivelin e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve në 10 komunat e synuara për vitin 2016. Është e rëndësishme të shikohet ky lloj krahasimi, sepse më lehtë e kuptojmë efektin real të masave të veçanta, por nxjerrim edhe përfundime të tjera që tregojnë se duhen ende angazhim në këtë drejtim.



Kjo grafikë si dhe të gjitha të tjerat të paraqitura më lartë për secilën komunë, janë publikuar edhe në mediat sociale. Kjo është bërë me qëllim të ndarjes së informatave të tilla dhe rritjes së vetëdijësisë publik lidhur me masat afirmative dhe nevojën për të e avancuar pozitën e gruas në shoqëri, pronë dhe jetën publike. Ky komunikim në media sociale, përkatësisht në facebook, ka nxjerrur një element shumë të rëndësishëm për këtë raport, dhe nevojën e madhe që ekziston për të e trajtuar të drejtën e barabart të gruas në pronë dhe shoqëri.

Kështu, në facebook është mundësia e komunikimit me publikun, dhe ofrimi i opinionit nga ana e publikut. Me qëllim që të ndajmë me gjithë ata që kanë mundësi të kenë në dorë këtë raport, dhe nuk kanë pasur mundësi të e shohin faqen e POLIS në facebook, të shohin disa nga komentet e lexuesëve. Ndoshta, ky është vlerësimi më i duhur për të matur vërtetë ekzistencën e një menatiliteti kulturorë në shoqërinë tonë që është sfidues për avancimin e pozitës së gruas në shoqëri.

Të shohim më poshtë disa nga këto komente të pa identifikuara me qëllim të ruajtjes së privatisë së tyre. Këto komente janë bërë në infografikën e publikuar me të dhënat për dhjetë komunat, në infografikën për komunën e Lipjanit si dhe në TV klipin promovues.

33,020 people reached

Edit Boost

4,010

Organic Reach

35,616

Paid Reach

2,047

Post Clicks

and 145 others

Faj kan procedurat e komplikume edhe te kushtushme

16 minutes ago · Like · Reply · Message

Per komunat e tjera a keni te dhena si p.sh Prizren, Dragash, Suhareke, Gjakove e Peje? Flm

Yesterday at 20:20 · Like · Reply · Message

Public Organization for Local Initiativ...
Jo Fjolla. Aktualisht kemi te dhena vetem per keto 9 komuna.

Yesterday at 23:47 · Like · Reply

Reply as Public Organization for Local Initia

Musli Bozhdaraj
Kjo harte nuk qenka askundi e perafert madje me harten normale te Kosoves,

27 minutes ago · Like · Reply · Message

Comment as Public Organizat...

Post

Kjo harte nuk qenka askundi e perafert madje me harten normale te Kosoves,

27 minutes ago · Like · Reply · Message

And you looking for a "Gold Diggers"

1 hour ago · Like · 1 · Reply · Message

Llaf po bojne keta, nuk e kane pernime :P

1 hour ago · Like · 1 · Reply · Message

Ne fakt keta po mundohen me na imponu qe me ndrru pasurin me familjen, tek ne nuk lihen motrat dhe prinderit rrugeve dhe ne meshiren e "shtetit", pavarsisht qka sjell fati i jetes se "motrave, prinderve, vlezerve" apo edhe te afermeve me te larget ne Shqiptaret tradicionalisht jemi kujdesur per ta pa pas nevoj me kerku ndihem e Shtetit, e keta pp mundohen mi shkatrru lodhjet shpirtorore mu lidh me pasurin

47 minutes ago · Like · Reply · Message

Ooo s'kane pune tjera keta. Projekt qe me i 'thith' do fonde. Kjo eshte e dijshme qe kurr askush s'ka mbet rrugeve.

45 minutes ago · Like · Reply · Message

Comment as Public Organizat...

Post

45 minutes ago • Like • Reply • Message

Te na ne Kosove edhe ashtu skemi pas kurr "back door" sepse skemi planifiku kurr me ik nga realiteti kirse kta po mindohen me na mesu se pari me dizajnu planin "B" (qka me shkrry) masnej me kqyr mu martu, kjo nuk dhez te na, edhe ashtu ne menyra vullnetare familjaret kur ju kam da femrav pasuri nuk e kan marr se kan mendu mu kthy ne gjini me pa te pamen te vllaznija e te prinderit kurse planin per tek dera e burrit e kan ndertu me nje jete garancion, mu plak e me dek bashk, e tash "gold diggers" veq a ka pare e mas dy vjete mu shkurorzu, e masnej mule me hap mje jetimore se gruja " e ve" i kartu me nje djal te ri "edhe aj gold digger" e burri e murr nje tjetet e ska kush kujdeset per fmi, ja pra kjo eshte ajo qe deshirojn organizatat e grave

21 minutes ago • Like • Reply • Message

Reply as Public Organization for Local Initia

Bravo Ferizaj

3 hours ago • Like • Reply • Message

Repost from

Comment as Public Organizat...

Post

Burrrat spo mujn me udhheq qysh duhet e leje gratë,merrnu me sene ma te menqura

Thursday at 16:37 • Like • 4 • Reply

Me kete mentalitet tburrelit si puna jote jemi ku jemi ncnncnnc **Veton**

Thursday at 16:52 • Like • 3 • Reply

Ahhahahahahahahahaa

Thursday at 17:04 • Like • Reply

Hahahahahahahahaha smujta mu duru pa kesh 🤔🤔🤔🤔

Thursday at 17:05 • Like • Reply

Write a reply...

Write a comment...



Post

Po edhe kto shenime jan te bartura nga e ish Jugosllavis kur pronat i kan regjistruer ne emer te nenave apo gjysheve per te marr Shtesat e Fmive mue ma merr mendja

Friday at 23:34 • Like • Reply

Kqyre ti qka pi shqetson, kta .. kqyrni merruni me naj pune se ja vlene.

Friday at 13:05 • Like • 3 • Reply

Pasqyrë e gjendjes, jan komentuesit! Mjerim, poooo mjerim! Ende ka treva në trojet e Kosovës, ku qohet ni msit me lyp ni rob! E po quditemi, pse Evropa na ka mbyll ne një burg sikur shtazët!

Saturday at 03:53 • Like • 1 • Reply

Ahhahahahahahahahaa

Thursday at 17:04 • Like • Reply

Hahahahahahahahaha smujta mu duru pa kesh 🤔🤔🤔🤔

Thursday at 17:05 • Like • Reply

Write a reply...

Përzihnu edhe ne patundshmëri se e knaqt tjetet sen

Thursday at 18:50 • Like • 2 • Reply

Met verte. Jem tuj hec para meksi,Illoj njerz....

Friday at 23:22 • Like • 1 • Reply




Write a comment...



Post

masa afirmative dhe stimuluese.



26 Shares 3.6K Views



Like




Comment



Share



You, [REDACTED] and 22 others



Me tjera sene e keni bo namin.
Kqyrni korrupsioni e kufijt ndreqni se mos po
kerset naj luft e tani ju bjen grave gjysen e
rruges me vozit traktorin deri ne kuks 🤔



4 minutes ago • Like • Reply



Write a comment...



Post

Komentet e publikut të shfaqura kundrejt inforgarfikave me këto dhëna tregojnë më së miri se çfarë në të vërtetë mendon një pjesë e shoqërisë për çështjen gjinore. Andaj, në bazë të këtyre komenteve dhe duke i përmbledhur me të gjitha të dhënat tjera n'a del duhet edhe më tepër angazhim për të e përmirësuar këtë gjendje. Por më e rëndësishme është të ndërhyhet në ndryshimin e mendësisë që ekzistonë në shoqëri. Kur kjo të ndodhë, përmirësimet tjera bëhen me lehtësiht.

B. PJESA E DYTË

6. Metodologjia dhe informata demografike

Ky raport prezanton të dhëna rreth zbatimit të Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve të miratuar nga Qeveria e Kosovës në shkurt të vitit 2016. Gjetjet e këtij hulumtimi janë të bazuara në intervistat e mbajtura me akterë të ndryshëm të cilët janë të përfshirë në zbatimin e të drejtës së grave në prone, dhe regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve.

Intervista janë mbajtur me (1) zyrtarë publik; (2) noterë; (3) zyrtar kadastral dhe të gjeodezisë, dhe; (4) zyrtar për barazi gjinore e përfaqësues të grupeve të grave asambleiste. Për secilën prej këtyre grupeve janë përdorur pyetësor të veçantë në bazë të kompetencave të cilët këto grupe i kanë. Intervistat janë realizuar gjatë muajve Nëntor-Dhjetor 2016, dhe kanë zgjatur mesatarisht prej 30 deri në 45 minuta. Të gjitha formularët e intervistave janë shqyrtuar, dhe të dhënat janë futur në databazën elektronike, janë kategorizuar dhe prezentuar në formë analitike në këtë raport.

Sa i përket grupit të parë të intervistave me zyrtarë publik, janë mbajtur gjithsejtë 126 intervista në komuna të ndryshme: 22 në Ferizaj, 18 në Lipjan, 16 në Prishtinë, 15 në Fushë Kosovë, 15 në Drenas, 12 në Kaçanik, 9 në Shtime, 7 në Shtërpçë, 6 në Hanin e Elezit dhe 6 në Obiliq. Prej 126 të intervistuarve, 54 kanë qenë femra, 71 meshkuj, ndërsa një formularë nuk e kishte gjininë të shënuar. Afër tri të katërat (74%) e pjesëmarrësve të intervistuar ishin të martuar, dhe afër tri të katërtat (74%) kishin të përfunduar arsimin e lartë.

Sa i përket grupit të dytë të intervistave me noterë, janë mbajtur 19 intervista në komuna të ndryshme të Kosovës: 6 në Prishtinë, 4 në Lipjan, nga 2 në secilën Fushë Kosovë, Drenas, dhe Ferizaj, dhe nga 1 intervistë në Shtime, Obiliq dhe Kaçanik. Vetëm 3 prej të intervistuarve noterë ishin femra. Përgjigjet në mes meshkujve dhe femrave notere nuk kanë pasur ndonjë dallim të theksuar që nevojitet të përmendet.

Sa i përket grupit të tretë të intervistave me zyrtarë kadastral, janë mbajtur gjithsejtë 16 intervista me zyrtarë të agjencisë kadastrale dhe zyrave kadastrale, prej të cilëve 2 kanë qenë nga Hani i Elezit, 2 nga Obiliqi, 2 nga Shtërpça, 2 nga Fushë Kosova, 1 nga Shtimja, 1 nga Kaçanik, 1 nga Lipjani, 1 nga Drenasi, 1 nga Prishtina, ndërsa 3 nuk e kanë pasur komunën e shënuar. Prej 16 të intervistuarve, vetëm 6 kanë qenë femra.

Së fundmi, në lidhje me grupin e katërt të intervistuarve, janë mbajtur 7 intervista me zyrtarë për barazi gjinore (Fushë Kosovë, Obiliq, Prishtinë, Lipjan, Hani i Elezit, Drenas, Shtime), dhe 2 intervista me përfaqësues të grave asambleiste në nivel lokal të Drenasit dhe Prishtinës. Gjetjet prej këtyre intervistave janë prezantuar bashkarisht më tutje në këtë raport.


Ky hulumtim është realizuar me resurse të kufizuara teknike dhe financiare, dhe është i pari raport i realizuar i këtij lloji që përfshinë mendimet dhe qëndrimet nga zyrtarë të ndryshëm kompetent për të drejtat e grave në pronë. Gjetjet e këtij raporti, edhe pse nuk janë përfaqësuese në nivel të vendit, shërbejnë si gjetje indikative të realitetit në Kosovë sa i përket të drejtës së gruar në pronë. Do të ishte e nevojshme që të realizohet një studim më gjithëpërfshirës i gjendjes në nivel shtetëror.

7. Gjetjet nga intervistat me akterë

7.1. Gjetjet nga Intervistat me zyrtarë publik


Kjo pjesë e raportit prezanton gjetjet nga 126 intervista me zyrtarë publik në nivel lokal. Një përqindje e madhe (41%) e të intervistuarve kishin deklaruar se gratë kanë mjaftueshëm apo plotësisht të drejta në Kosovë. Shumë (42%) prej të intervistuarve kishin deklaruar se gratë kanë mesatarisht të drejta, ndërsa vetëm një përqindje relativisht e ulët (14%) ishin të mendimit se gratë kanë pak ose aspak të drejta.

Mirëpo, kur të njëjtit janë pyetur se sa kanë të drejta gratë në pronë, më shumë se gjysma (58%) ishin të mendimit se gratë kanë pak ose aspak të drejta, afër një e treta (31%) kishin theksuar se kanë mesatarisht, ndërsa vetëm një përqindje relativisht e vogël (11%) kishin deklaruar se gratë kanë mjaftueshëm apo plotësisht të drejta. Perceptimet e të intervistuarve për të drejtat e grave në pronë janë shumë më negative në krahasim me perceptimin për të drejtat e grave në përgjithësi.



Kur janë pyetur se a kanë gratë dhe burrat posedim të barabartë të pronës, pothuajse një e treta (30%) ishin përgjigjur se kanë pak ose aspak, dhe ngjajshëm, afër një e treta (32%) kishin vlerësuar se kanë mjaftueshëm apo plotësisht. Një përqindje e konsiderueshme e të intervistuarve kishin deklaruar se nuk e dinë, apo kishin shmangur të i përgjigjen kësaj pyetje.

Pothuajse të gjithë të intervistuarit ishin të njoftuar lidhur me Udhëzimin Administrativ për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së përbashkët. Kur janë pyetur nëse mendojnë se duhet të përdorën masa afirmative që stimulojnë pjesëmarrjen e grave në prone, shumica (92%) e pjesëmarrësve kishin deklaruar se mbështesin këto masa. Shumica e të intervistuarve (96%), gjithashtu mendojnë se masat afirmative janë mënyra adekuate për avancimin e të drejtave të grave, dhe se ato duhet të vazhdohen (98%). Kjo tregon që zyrtarët public në nivel lokal i vlerësojnë të nevojshme masat afirmative për provovimin e të drejtave të grave në Kosovë, përfshirë këtu edhe të drejtën për regjistrimin e përbashkët të pronës në mes bashkëshortëve. Shumica e të intervistuarve kishin deklaruar se të drejtat e grave në pronë ndikojnë në mirëqënien e grave dhe familjes e shoqërisë në përgjithësi.




Kur janë pyetur që të përmendin ndonjë përfitim që sjellë posedimi i pronës për gratë, përgjigja më e zakonshme ishte se kjo iu jep grave stabilitet ekonomik dhe iu ndihmon që të jenë financiarisht të pavarura. Një numër shumë i madhë i pjesëmarrësve ishte përgjigjur se e drejta e grave në pronë iu ndihmon grave që të zhvillojnë biznese “[gruaja] është më e fuqishme ekonomikisht, mund të hap ndonjë biznes” ishte përgjigjur një femër e intervistuar. Një femër tjetër e intervistuar kishte deklaruar se gratë përmes së drejtës në pronë “kanë mundësi të shumëta, veçanërisht stabilitet ekonomik e mundësi të hipotekës për ndonjë kredi eventuale”.

Një përgjigje tjetër e zakonshme ishte se e drejta në pronë i ofron gruas siguri më të madhe. Një pjesëmarrëse femër e pa-martuar kishte vlerësuar se nëse ke pronë “ke siguri, dhe ke një kulm mbi kokë”. Një mashkull i intervistuar kishte theksuar se “në rast divorci [femra] ka mbështetje”. Përgjigjet e tjera të ofruar nga të intervistuarit ishin se pjesëmarrja e grave në pronë ndihmon stabilitetin dhe mirëqënien e familjes, siguron liri më të madhe të shprehjes dhe veprimit për gruan, dhe ngritë vetëbesimin e gruas për të marrë pjesë në jetën shoqërore dhe ekonomike.


Përveç mendimeve të tyre të përgjithshme në lidhje me të drejtat e grave dhe në lidhje me masat afirmative, të intervistuarit janë pyetur edhe për të drejtat në jetën e tyre personale, për të vlerësuar se deri në çfarë mase vetë të intervistuarit apo familjet e tyre zbatojnë masat e udhëzimit administrative.

Të intervistuarit të cilët ishin të martuar janë pyetur nëse ata personalisht kanë pronë të regjistruar në emrin e tyre. Meshkujt kishin më shumë se dyfishë gjasa që të kenë pronë të regjistruar në emërin e tyre në krahasim me femrat. Tri të katërtat e femrave të martuara (75%) nuk kishin ndonjë pronë të regjistruar në emrin e tyre, në krahasim me më pak se gjysën (42%) e meshkujve.




Prej atyre të cilët kanë qenë të martuar dhe që kanë pasur pronë në emër të tyre, ka një përqindje të ngjajshme të meshkujve (76%) dhe femrave (63%) të cilët kanë deklaruar se bashkëshorti(ja) i(e) tyre nuk është pronar i(e) përbashkët në pronën e tyre. Kjo tregon që të dy

gjinitë, përfshirë edhe femrat kur ato kanë pronë, në shumicën e rasteve nuk e regjistrojnë bashkëshortin si pronar të përbashkët.




Më tutje, afër dy të tretat (64%) e femrave të martuara kishin deklaruar se bashkëshortët e tyre kanë pronë në emrin e tyre. Prej atyre femrave të cilat kishin deklaruar se bashkëshortët e tyre kanë pronë, dy të tretat (67%) nuk kanë kërkuar nga bashkëshorti që të bëhen pronarë e përbashkët në pronë. Kjo tregon që, edhe pse femrat e intervistuar në përgjithësi kanë njohuri për të drejtat e tyre në pronë të përbashkët, ato nuk janë të emancipuara në atë nivel sa të kërkojnë të drejtat e tyre që të bëhen pronar të përbashkët të pronës.




Më tutje, pjesëmarrësit janë pyetur nëse e kanë bërë ndarjen e pasurisë së trashëguar nga baba, nëna apo trashëgimtarë të tjerë. Vetëm një e treta (34%) e të intervistuarve e kishin bërë ndarjen e pasurisë së trashëguar, përderisa një përqindje e lartë (61%) nuk e kishin bërë

këtë. Procedurat e ndërlikuara, burokracia institucionale, dhe kostoja e lartë e shërbimeve kadastrale, mund të kenë ndikuar në përqindjen kaq të lartë të intervistuarve të cilët nuk e kanë ndarë pasurinë.


Nuk është vërejtur ndonjë dallim i theksuar ndërmjet gjinive në lidhje me ndarjen e pasurisë. Por, kur femrat të cilat kanë deklaruar se e kanë ndarë pasurinë janë pyetur nëse kanë marrë hisen e tyre nga pasuria e trashëguar, më shumë se gjysma (56%) nuk e kishin marrë, afër një e treta (28%) e kishin marrë, ndërsa një përqindje e konsiderueshme (16%) nuk ishin përgjigjur fare në këtë pyetje.




Më tutje, të intervistuarit e gjinisë femrore janë pyetur nëse do të pranonin hise sikur familja e tyre e shqyrton ndarjen e trashigimisë pronësore. Vetëm një e treta (35%) e femrave ishin deklaruar që do të pranonin hise. Një pjesë e konsiderueshme (39%) nuk e dinë, ose nuk kishin përgjigje. Më shqetësuese është që një e katërta (26%) e femrave nuk do të pranonin hise. Kjo tregon që ndarja e trashigimisë udhëhiqet nga e drejta zakonore në të cilën dominojnë meshkujt, ndërsa femrat nuk janë të emancipuara as për të kërkuar, as për të pranuar trashigiminë në pronë edhe nëse iu ofrohet nga familja. Në anën tjetër, kur janë pyetur meshkujt nëse do të pranonin që të marrin hise motrat e tyre në pasurinë e trashëguar, shumica (73%) kishin thënë se do të pranonin një gjë të tillë, ndërsa një përqindje e kufizuar (13%) kishin thënë se nuk do të pranonin.



Edhe pse të dhënat e prezantuara më lartë për përqindjen e grave që marrin, ose që do të pranonin, hise nga familjarët e tyre janë shqetësuese, pothuajse gjysma e të intervistuarve (46%) vlerësuan se gjendja e gruas në lidhje me trashëgiminë në pronë është me trend pozitiv. Megjithatë, më shumë se një e treta e femrave vlerësuan se gjendja e gruas në trashëgimi në pronë është jo e mire. Në krahasim me meshkujt, femrat kanë 3 herë më shumë gjasa të besojnë se gjendja e gruas në trashëgimi dhe në pronë është në trend negativ.



Kur janë pyetur se cilët faktorë ndikojnë në trashëgiminë në pronë dhe regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve, ndjenja e patriarkalizmit ka qenë faktori më i theksuar (59%), ndjekur nga mos-informimi i duhur për ligjin (25%). Më shumë se gjysma (52%) e pjesëmarrësve ishin të mendimit se mungesa e legjislacionit adekuat nuk është faktor që ndikon në trashëgiminë në pronë dhe regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve. Nuk kishte ndonjë dallim të theksuar në përgjigjet e meshkujve dhe femrave në këtë pyetje.



7.2. Gjetjet nga intervistat me noterët

Kjo pjesë e raportit prezanton gjetjet nga intervistat me 19 noter në komuna të ndryshme të Kosovës. Ka pasur një llojllojshmëri të përgjigjeve nga noterët kur janë pyetur se çfarë mendojnë në lidhje me udhëzimin administrativ. Shumica prej noterëve kishin deklaruar se është një udhëzim i nevojshëm që ka për qëllim avancimin e barabartë të të dy gjineve, duke përkrahur të drejtën e femrave në pronë. Shumica e noterëve e vlerësojnë se udhëzimi administrativ ka pasur ndikim pozitiv në promovimin e të drejtës së gruas në prone përmes regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve.

Ka pasur mendime të ndryshme në mes të noterëve në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e këtij udhëzimi. Disa noterë e vlerësojnë se udhëzimi nuk është në përputhje me Ligjin për Familje dhe Kushtetutën e Kosovës - por nuk kishin dhënë ndonjë argument për këtë vlerësim. Disa të tjerë vlerësuan se çështjet të cilat rregullohen me këtë udhëzim vetëm se janë të mbuluara me Ligjin për Familje, dhe mendojnë se udhëzimi ka qenë i panevojshëm.

Kur janë pyetur për rolin e noterëve në lidhje me udhëzimin, noterët kanë pasur pothuajse mendim unanim se noterët e zbatojnë udhëzimin për të avancuar të drejtën e grave në shoqëri. Noterët theksuan se asnjë noter nuk duhet të lëshoj akt noterial pa marrë paraqysh ndonjë dokument që ka për qëllim mbrojtjen e gruas, ose pa pasur pëlqimin e gruas.

“...besoj që ky udhëzim administrativ është zbatuar nga të gjithë noterët.”

Noter mashkull në Prishtinë

Kur janë pyetur se si e bëjnë informimin e palëve lidhur me masat e udhëzimit administrativ, noterët pothuajse në formë unanime ishin përgjigjur se kur të vijnë palët për të procesuar dokumente, ata i njoftojnë palët për të drejtat dhe obligimet që dalin nga ky udhëzim, në përputhje me interesat e tyre pronësore. Një noter kishte theksuar “para aktvendimit bëhet informimi i palëve për të drejtat në bashkëpronësi”. Një noter tjetër kishte theksuar se “i obligojmë palët që të sjellin certifikatën e martesës dhe pëlqimet e bashkëshortëve”. Të gjitha përgjigjet e noterëve ishin uniforme se informimi bëhet vetëm kur palët vijnë në zyrë. Nuk kishte ndonjë përgjigje që shfaqë ndonjë angazhim pro-aktiv të noterëve për të informuar qytetarët apo palët para se të vijnë në zyrë, shpërndarje të broshurave, apo materialeve të tjera informuese.


Pothuajse të gjithë noterët theksuan se kanë bashkëpunim të vazhdueshëm me zyrat kadastrale për zbatimin e udhëzimit administrativ. Një prej noterëve kishte theksuar se jemi të obliguar që të bashkëpunojmë me zyrën kadastrale, sepse çdo kontratë që bëhet tek noterët duhet të

regjistrohet edhe në zyrat kadastrale. Pothuajse asnjë nga noterët nuk bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore. Vetëm një notere në Prishtinë, kishte deklaruar se merr pjesë në mënyrë të vazhdueshme në punëtoritë e organizuara nga Zyra për Barazi Gjinore.

Kur janë pyetur nëse ka ndonjë pengesë administrative ose tjetër në zbatimin e masave nga institucionet e tjera, noterët në përgjithësi kishin deklaruar se nuk besojnë që ka ndonjë pengesë apo problem. Megjithatë, kishte disa noterë të cilët theksuan se nganjëherë hasin në vështirësi për t'i procesuar kontratat meqenëse shërbimi nuk mund të kryhet nëse nuk janë të dy bashkëshortët. Një noter kishte theksuar se ka raste kur ndonjëri prej bashkëshortëve është jashtë vendit, dhe kjo mund të merr kohë deri sa të jep pëlqimin bashkëshorti jashtë vendit. Një pengesë tjetër që ishte përmendur nga noterët ishte taksa komunale, e cila është ngarkesë e dyfishtë për palët.


Shumica e noterëve kishin deklaruar se palët janë pjesërisht të informuar në lidhje me masat e UA-së. Vetëm disa prej tyre kishin theksuar se palët nuk janë aspak të informuara, dhe vetëm një kishte theksuar se palët janë të plotësisht të informuara. Edhe gjetjet nga intervistat e tjera me zyrtarët kadastral kanë treguar se në përgjithësi palët kanë njohuri se prona duhet të regjistrohet në emër të dy bashkëshortëve.

Kur janë pyetur nëse palët të cilat janë plotësisht të informuara pranojnë të regjistrojnë pronën me emrat e të dy bashkëshortëve, një numër i konsiderueshëm i noterëve kishin theksuar se pranojnë. Në disa raste, noterët kishin theksuar se varet prej palëve, në disa pranojnë e disa jo. Kjo gjetje nuk është në përputhje me gjetjet e prezentuara më lartë nga intervistat me zyrtarët publik mbi pjesëmarrjen e ulët të grave në prone.



Kur janë pyetur se si reagojnë palët të cilat janë pjesërisht ose aspak të informuar kur njoftohen nga noterët për masat e udhëzimit administrative, noterët kishin pasur përgjigje të llojllojshme. Shumica e noterëve deklaruan që edhe pse palët nuk tregojnë ndonjë protestë të hapur ndaj udhëzimit, zakonisht informata nuk mirëpritet nga meshkujt, përderisa femrat e mirëpresin këtë udhëzim. Për disa meshkuj, ky udhëzim vjen si befasi, mirëpo disa të tjerë shprehin gatishmëri për të respektuar udhëzimin. Noterët kishin theksuar se gjithashtu varet prej vendbanimit, palët që vijnë nga zonat urbane kanë më shumë gjasa ta pranojnë udhëzimin se sa palët që vijnë nga zonat rurale. Vetëm një noter kishte deklaruar se nganjëherë palët nuk pranojnë, për shkak të aplikimit të tarifave të dyfishta.

Kur janë pyetur se sa është numri i rasteve për të cilat është regjistruar prona e përbashkët, disa prej noterëve kanë deklaruar se nuk kanë statistika, ndërsa prej noterëve që kanë deklaruar statistikat, ka pasur përgjigje prej 4 deri në 40 raste. Dy noter kishin theksuar se megjithatë, numri i rasteve për të cilat është regjistruar prona e përbashkët është në trend pozitiv të rritjes.



Në përgjithësi, noterët ishin të mendimit se masat afirmative të udhëzimit administrativ janë efektive dhe se duhet të vazhdojnë. Disa prej noterëve e konsideruan këtë si të panevojshme, për shkak që sipas tyre çështjet që mbulohen me këtë udhëzim janë të mbuluara me Ligjin për Familje. Dy noterë tjerë propozuan që udhëzimi administrativ të shëndrrohet në normë ligjore. Kjo tregon që noterët kanë interpretime të ndryshme të ligjit, që mund të shpie në situata kur noterët ofrojnë shërbime të cilat nuk janë konsistente me noterët e tjerë.

Kur janë pyetur se çfarë do të propozonin noterët në lidhje me të drejtat e grave, disa theksuan nevojën për eliminimin e barrierave për raportimin e pasurive bashkëshortore (për shembull heqja e taksave pronësore), dhe nevojën për informimin e familjeve dhe grave në përgjithësi për të drejtat e tyre pronësore. Shumica (13 nga 19) e noterëve pajtohen që të obligohet regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve.

Noterët e intervistuar në përgjithësi nuk mendojnë se duhet të ketë ndonjë ndryshim në ligjin për Noterët në raport me fuqizimin e gruas. Sipas noterëve, ligji për noterët është i njëjtë dhe i zbatueshëm për të gjithë në mënyrë uniforme, ndërsa çështjet që kanë të bëjnë me pronësinë, duhet të rregullohen përmes Ligjit për Familje, apo ligjeve të tjera që kanë të bëjnë me trashigiminë në pronë. Disa propozime nga noterët ishin: të ndryshohet ligji që të obligohet blerësi për regjistrimin në emër të dy bashkëshortëve, të përfshihen edhe pasuritë e luajtshme, dhe të jetë normë imperative që prona të regjistrohet në emër të dy bashkëshortëve.

Kur janë pyetur për pjesëmarrjen e femrave në trashigimi, shumica e noterëve kanë theksuar se pjesëmarrja është shumë e ulët apo e paknaqshme. Sipas noterëve, ka raste të cilat janë më të zakonshme në zonat rurale, kur femrat deklarojnë se nuk e pranojnë pronën. Por sipas noterëve, kjo varet nga emancipimi i të dy gjinive.

Sipas noterëve, detyra e noterit janë që t'i informoj palët në lidhje me të drejtat e tyre, por përderisa ligji i mundëson femrat që të heqin dorë nga prona tyre, noterët nuk mund të bëjnë më tepër se sa të zbatojnë mirëkuptimin e palëve në proces. Disa noter theksuan se e drejta në pronë duhet të garantohet dhe të mbrohet me ligj, dhe përderisa nuk është kështu, ata nuk mund të bëjnë më tepër. Një rol tjetër i përmendur ishte që noterët mund të bëjnë informimin e grave dhe femrave, por informimi më gjithëpërfshirës duhet të bëhet nga institucionet e tjera sipas noterëve.

7.3. Gjetjet nga zyrtarët kadastral

Kjo pjesë e raportit prezanton gjetjet nga intervistat me 16 zyrtarë kadastral dhe të gjeodezisë në nivel lokal. Kur janë pyetur se cili është roli i Agjencisë Kadastrale dhe Zyrave Kadastrale në zbatimin e udhëzimit administrativ, shumica e pjesëmarrësve janë përgjigjur se roli kryesor është që të zbatoj udhëzimin në bazë të dispozitave të përcaktuara në të. Përgjigjja e dytë më e zakonshme ishte se agjencitë dhe zyrat kadastrale mund të kontribuojnë në informimin e qytetarëve në lidhje me dispozitat e udhëzimit, dhe të ngrisin vetëdijen e qytetarëve për regjistrimin e pronave të përbashkëta. Vetëm një i intervistuar ishte i mendimit që zyra

kadastrale mund të luaj rolin e monitoruesit të zbatimit të këtij udhëzimi. Sipas të intervistuarve, disa prej mekanizmave të zyrës Kadastrale për zbatimin e udhëzimit janë: heqja e taksës për regjistrim, lrimi nga pagesat, regjistrimi i pronave të përbashkëta, dhe zbatimi i dokumentacionit të pranuar nga noterët, gjykatat dhe institucionet e tjera përkatëse.

Kur janë pyetur se cilat janë veprimet konkrete që agjencia apo zyra kadastrale ka ndërmarrë për të zbatuar masat nga ky udhëzim, disa prej veprimeve më të zakonshme ishin këshillimi i palëve, mbajtja e takimeve me zyrat kadastrale të komunave, dhe takimet e përbashkëta me zyrën për barazi gjinore (sidomos nëpër fshatra). Vetëm një zyrtar kishte deklaruar se ka vendosur poster informues brenda objektit për të shpjeguar që palët të regjistrojnë pronën e përbashkët.

Sipas zyrtarëve komunal, femrat në përgjithësi do të përfitonin në masë të madhe nga zbatimi i masave për udhëzimin administrativ. Shumica e të intervistuarve ishin të mendimit që zbatimi i udhëzimit i bën femrat financiarisht të pavarura, dhe iu mundëson atyre që të kenë një jetë të sigurtë dhe të pavarur. Sipas të intervistuarve, zbatimi gjithashtu do të kontribuonte në stabilitetin e lidhjes familjare, pasi që bashkëshorti do të kishte të pamundur që të shes pronën pa pëlqimin e gruas. Në krahasim me zyrtarët publik, të cilët kishin vendosur theks të veçantë në argumentin se zbatimi do të iu ndihmonte femrave të hapin biznes, vetëm një prej zyrtarëve kadastral ishte i këtij mendimi. Gjithashtu, vetëm një zyrtar kadastral kishte theksuar se në rast divorci, do të bëhej ndarje e barabartë e pronës dhe kjo do të ndikonte në mirëqenien e gruas.

“...në shumicën e rasteve femra po kontribuon në pasurinë e përbashkët, dhe me regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve, [femra] bëhet më e fuqishme ekonomikisht.”

*Zyrtare kadastrale femër në
Fushë Kosovë.*


Sipas zyrtarëve kadastral, para hyrjes në fuqi të udhëzimit administrativ, ka pasur raste shumë të rralla, apo nuk ka pasur asnjë rat, kur prona është regjistruar në emër të dy bashkëshortëve. Shumica e zyrtarëve kadastral nuk kujtojnë të kenë pasur ndonjë rast, apo ndër rastet e rralla të cilat janë regjistruar kanë qenë kur femra ka kontribuar financiarisht në pronë, ose raste të cilat janë regjistruar nga pjesëtar të popullatës nga diaspora. Sipas zyrtarëve kadastral, gruaja ende është e diskriminuar në të drejtën në pronë, dhe nuk është e barabartë me mashkullin. Kjo është një gjetje që mbështetet nga të gjitha intervistat, përfshirë zyrtarët komunal, noterët, zyrtarët kadastral dhe ata të barazisë gjinore.

Mirëpo që nga hyrja në fuqi e udhëzimit administrativ, pothuajse të gjithë të intervistuarit e këtyre grupeve pajtohen që ka një trend pozitiv në rritjen e rasteve kur prona është regjistruar

në emër të dy bashkëshortëve. Prej zyrtarëve kadastral, 7 nga 15 të intervistuar kishin theksuar se është në trend të mirë të zbatimit, ndërsa 5 kishin vlerësuar se ende është herët për të vlerësuar. Vetëm një zyrtar kadastral kishte konsideruar se gjendja është e njëjtë me vitet e kaluara. Në përgjithësi vërehet se udhëzimi administrativ, edhe pse në fazat e hershme të zbatimit, ka pasur efekt ndihmues në rritjen e pjesëmarrjes së gruas në pronë.

Si e vlerësoni trendin e zbatimit të UA-së deri më tani	Nr. i përgjigjeve
Është në trend të mirë të implementimit	7
Ende është herët për të parë rezultatet	5
Ende nuk është duke u vërejtur ndonjë përmirësim i theksuar	2
Trendi i regjistrimit vazhdon të mbetet i njëjtë me vitet paraprake	1

Sipas zyrtarëve kadastral, palët me të cilët ata kanë kontakt në shumicën e rasteve janë pjesërisht të informuar për masat e udhëzimit administrativ, ndërsa në disa raste, i dijnë plotësisht masat afirmative të këtij udhëzimi. Asnjë prej të intervistuarve nuk deklaroi që palët nuk kanë informata, dhe kjo ndoshta ka të bëjë për shkak që palët informohen nga noteri para se të shkojnë në zyret kadastrale.



Sipas gjysmës prej të intervistuarve, ka pasur raste kur burrat kanë qenë të informuar, mirëpo nuk kanë pranuar që ta regjistrojnë pronën në emër të përbashkët. Arsyeja kryesore pse kjo ndodhë është se burri deklarohet se vetë e ka bërë pagesën dhe se duhet të regjistrohet në emër të burrit. Një zyrtarë kadastrale femër kishte theksuar se “shumica deklarojnë se femrat nuk kanë dhënë kontribut në pasurinë e përbashkët” dhe për këtë arsye nuk regjistrohen si bashkëpronare.

Shumica e të intervistuarve nuk mendojnë që nevojiten ndryshime ligjore për të avancuar të drejtën e gruas në pronë. Disa zyrtarë kadastral mendojnë se pozita e gruas ligjërisht është e barabartë, por në praktikë ende udhëhiqet nga e drejta zakonore. Pothuajse të gjithë zyrtarët ishin të pajtimit se masat afirmative për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve, dhe për pjesëmarrjen e gruas në trashigiminë në pronë, duhet të vazhdojnë, sepse ato kanë pasur një efekt pozitiv në avancimin e të drejtave të grave në pronë.

7.4. Gjetjet nga zyrtarët për barazi gjinore dhe grupet e grave asambleiste

Kjo pjesë e raportit i prezanton gjetjet nga intervistat me 7 zyrtarët për barazi gjinore dhe 2 grupet e grave asambleiste. Sipas zyrtarëve për barazi gjinore, agjencia për barazi gjinore dhe zyrtarët për barazi gjinore nuk kanë ndonjë mekanizëm të veçantë për ta zbatuar udhëzimin administrativ. Megjithatë, sipas tyre, ata mund të ndihmojnë në disa mënyra: mbikqyrja e zbatimit, bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe grupin e grave deputete në nivel lokal, motivimi dhe informimi i qytetarëve për të zbatuar udhëzimin në praktikë.

Zyrtarët për barazi gjinore theksuan se mund të përdorin fushatat promovuese, postimet në uebfaqe, shpërndarjen e posterave, bisedat me zyrtar të kadastrit, debatet publike në zona rurale, si mjete që mund të ndikojnë në zbatimin e udhëzimit. Kur ishin pyetur nëse ata mund të ndërmarrin ndonjë veprim për të zbatuar masat nga udhëzimi, pothuajse të gjitha përgjigjet e zyrtarëve për barazi gjinore ishin të fokusuara tek informimi i qytetarëve.

Shumica e zyrtarëve për barazi gjinore theksuan se target i fushatave të informimit kanë qenë jo vetëm femrat, por edhe gjinia mashkullore. Sipas zyrtarëve, në debatet apo tryezat të cilat ata i kanë organizuar janë ftuar meshkuj përfaqësues të shoqërisë civile, panelistë në debate, dhe janë angazhuar edhe akterë të tjerë përfshirë noterë, avokat, dhe zyrtarë të tjerë komunal. Në takime të ngjajshme kishin deklaruar se angazhohen edhe përfaqësuesit e grupeve të grave asambleiste të intervistuar.

Sipas zyrtarëve për barazi gjinore, gratë përfitojnë në mënyrë të dukshme nga regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve. Ngjajshëm me përgjigjet e zyrtarëve kadastral, dhe me përfaqësueset e grupeve të grave asamblesite, përfitimi kryesor i përmendur është përfitimi ekonomik i gruas, mundësia që gruaja të hap biznes, dhe krijimi i një jete më të sigurtë për gruan. Disa të intervistuar theksuan se kjo përmirëson gjendjen familjare, dhe ngritë vetëbesimin e femrave si pjesë e shoqërisë me të drejta të barabarta.

“...femra bëhet pjesë e kontributit, ndihmon në krijimin e biznesit, sigurinë në investimin e saj.”

*Zyrtare publike femër në
Prishtinë.*

Të gjithë zyrtarët për barazi gjinore e mirëpresin udhëzimin administrativ, dhe e vlerësojnë si pozitiv ndikimin e udhëzimit në të drejtat e grave në pronë. Një i intervistuar mashkull kishte theksuar se “është një udhëzim i vlefshëm, sepse ka filluar regjistrimi në emër të dy bashkëshortëve”. Shumica e zyrtarëve për barazi gjinore nuk mendojnë se procesi i të drejtës së grave në pronë është duke çaluar.

Sipas zyrtarëve komunal, institucionet kompetente mund të ndërmarrin disa aktivitete për të fuqizuar ekonomikisht gruan përmes së drejtës pronësore. Këto përfshijnë përkrahjen e femrës për të hapur biznes përmes subvencioneve, të përfshihet kjo çështje në kurrikulën e arsimit, të bëhet obligative marrja e trashigimisë, dhe të zbatohen masa ndëshkuese në rast të moszbatimit të ligjit për të drejtat e barbarta. Sipas përfaqësuesve të grupeve të grave asamblesite, mediat dhe OJQ-të duhet të përfshihen që të avancojnë pozitën e gruas në pronë dhe trashigimi.

Pothuajse asnjë nga zyrtarët për barazi gjinore nuk kishin dijeni për procesin e ndryshimit të ligjeve për Trashëgimi, Noteri dhe Procedurën jo-kontestimore. Vetëm një zyrtar nga Shtimja ishte informuar për këto procese, dhe kishte theksuar se vazhdimisht ftohen të marrin pjesë në tryeza të tilla ku ata mund të kontribuojnë në ndryshime ligjore. Të informuar për këtë process kishin qenë edhe përfaqësueset e grupeve të grave asambleiste të intervistuar.

8. Përmbledhje nga të gjitha intervistat

Kjo pjesë e raportit bënë një përmbledhje nga të gjitha intervistat e mbajtura, përfshirë intervistat me zyrtar publik, noter, zyrtar kadastral, zyrtar për barazi gjinore dhe përfaqësues të grupeve të grave asambleiste. Të intervistuarit kishin disa qëndrime të përbashkëta në lidhje me regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe të drejtën e grave në pronën e trashëguar.

E para, të gjitha grupet e intervistuar ishin të qëndrimit se gjendja momentale në lidhje me të drejtën e grave në pronë dhe regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve nuk është e mirë. Ka shumë më pak gra të cilat kanë pronë në emrin e tyre në krahasim me burrat. Në shumicën e rasteve, gratë nuk marrin hise nga prona e trashëguar dhe nuk janë të emancipuara që të kërkojnë të marrin hise. Kjo përkundër faktit se pothuajse tri të katërtat e meshkujve të intervistuar kishin deklaruar që nëse bëjnë ndarjen e pasurisë, janë të gashtëm të dhurojnë hisen e merituar motrave të tyre.

E dyta, të gjitha grupet e intervistuar ishin të mendimit se në përgjithësi qytetarët janë mesatarisht të informuar në lidhje me udhëzimin administrativ. Noterët deklarojnë se ata janë të obliguar që të zbatojnë masat e udhëzimit administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve, por nganjëherë ka raste kur burrat deklarojnë që prona është e blerë prej tyre pa kontributin e gruas, ose femra heq dorë nga prona në mënyrë vullnetare - edhe pse kjo mund të jetë e ndikuar nga shoqëria patriarkale dhe zakonet. Palët që vijnë nga zonat urbane,

dhe pjesëtarët e diasporës kanë më shumë gjasa të pranojnë masat e udhëzimit administrativ në krahasim me palët që vijnë nga zonat rurale.

E treta, pothuajse të gjitha grupet kanë vlerësuar se udhëzimi administrativ, edhe pse në faza fillestare të zbatimit, ka pasur efekt në avancimin e të drejtës së gruas në pronë. Sipas të intervistuarve, prej hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, janë regjistruar shumë më shumë raste të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Kanë qenë vetëm disa noterë të cilët e kanë vlerësuar se udhëzimi ka qenë i pa-nevojshëm, pasi që sipas tyre, çështja e regjistrimit të pronës në emër të përbashkët dhe e drejta e gruas në pronën e trashëguar vetëm se kanë qenë të garantuara përmes Ligjit për Familje, dhe ligjeve të tjera relevante.

E katërta, sipas të gjithë të intervistuarve, gratë do të përfitonin në mënyrë të dukshme nëse realizohet e drejta e tyre në pronë. Shumica e të intervistuarve kishin theksuar se kjo do të ndihmonte gruan që të jetë ekonomikisht e pavarur. Befasuese ka qenë numri i lartë i të intervistuarve të cilit kishin vënë theks të veçantë se gratë mund të bëhen shumë më aktive përmes hapjes së bizneseve, marrjes së kredive dhe zhvillimit të ideve të tyre.

E pesta, pothuajse të gjitha grupet kanë vlerësuar se korniza ligjore garanton grave të drejta të barabarta në pronë. Por sipas të intervistuarve, posaçërisht zyrtarëve për barazi gjinore, problemet kryesore janë që në praktikë kjo çështje ende udhëhiqet nga e drejta zakonore. Për këtë arsye, nevojiten të zbatohen fushata edukative dhe informuese që burrat dhe gratë të jenë të barabartë për qasjen e tyre në pronë.

Këto ishin gjetjet kryesore të të gjitha intervistave. Do të ishte shumë e nevojshme që një studim i tillë të realizohet në nivel vendi, për të mësuar edhe më thellë rreth zbatimit të udhëzimit administrativ, dhe për të arritur qëllimin e përbashkët të barazisë gjinore në lidhje me të drejtën në pronë.

9. Të gjeturat e përtgjithshme

Në bazë të aktiviteve të ndërmarruar nga projekti izabtuar me qëllim të nxitjes dhe informimit të qytetarëve për masat afirmative dhe rëndësinë e regjistrimit të pronës edhe në emër të grave, janë nxjerrur disa të gjetura tejet relevante. Këto të gjetura mundësojnë të kemi një vlerësim sa më të qartë të ecures së zbatimit të Udhëzimit dhe masave afirmative, dhe njëherit të kemi një prezantim të opinionit të caktuar në lidhje me të drejtat pronësore të grave.

- ✚ Një e gjetur e gjithë këtij procesi është se masat afirmative të përfshira në këtë Udhëzim, sado që kanë pasur qëllimin e mirë, duket se nuk është analizuar mirëfilli gjendja nëpër komuna, duke përfshirë nivelin takskat dhe tarifat të cilat ekzektohen me rastin e regjistrimit të pronës në regjistrat publik.
- ✚ Ky udhëzim ka mënjanuar tarifën e regjistrimit të pronës kur kjo bëhet në emër të të përbashkët, ashtu sikur e përcakton Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2014. Por, ekziston edhe një taksë tjetër komunale që zbatohet me rastin e regjistrimit të pronës, taksa transaksionit e cila është shumë më e lartë se tarifa e regjistrimit.
- ✚ Shumica e Komunave të targetuara nuk e zbatojnë fare tarifën e regjistrimit që është në vlerë prej 20 Euro, por vetëm taksa e transaksionit.
- ✚ Disa komuna e kanë zbatuar këtë masë, duke i liruar rastet që regjistrojnë pronën në emër të dy bashkëshortëve nga tarifa e regjistrimit, por nuk i kanë liruar nga taksa e transaksionit (Komuna e Prishtinës dhe e Drenasit).
- ✚ Komuna e Prishtinës ka bërë ekzekutimin e taksës së dyfishtë të transaksionit, duke i ngarkuar të dy bashkëshortët me nga 150 Euro taksë, në total 300 Euro për regjistrim. Kjo ka qenë një dekurajim i madhë për qytetarët që kanë dashur të regjistrojnë në emër të dybashkëshortëve pronën e përbashkët.
- ✚ Ndoshta ky ka qenë shkak që në Komunën e Prishtinës të kemi një regres në kuptim të regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve në krahasim me vitin 2015.
- ✚ Komunitat tjera targetuara kanë zbatuar këtë udhëzim duke i liruar bashkëshortët që regjistrojnë pronën në emër të përbashkët, nga taksa mbi transaksionin, për të cilën gjë nuk kanë qenë të obliguar. Kjo është një gjë pozitive në kuptim të mbështetjes së të drejtave të gravë në pronë, por njëkohësisht tregon për një komunikim joefektiv në mes gjithë akterëve relavant dhe të përfshirë në këtë proces.
- ✚ Në përgjithësi, Udhëzimi Administrativ 03/2016 duket se ka pasur efekt pozitiv në rritjen e numrit të rasteve që regjistrojnë pronën në emër të dy bashkëshortëve, por edhe të ndërgjegjësimit qytetarë.
- ✚ Informimi në lidhje me masat në fuqi për lirim nga tarifa e regjistrimit duket se ka munguar. Janë përdorur disa mekanizma apo mjete të promovimit të këtij udhëzimi, megjithatë ka pasur paqartësi edhe në vet akterët përgjegjës për zbatim të këtij udhëzimi, e aq më tepër tek qytetarët.
- ✚ Një e gjetur tek Noterët në Prishtinë, është se nuk e kanë pasur të qartë se Komuna e Prishtinës a është duke e zbatuar udhëzimin, dhe cilën taksë janë duke mos e ekzekutuar. Kur këtë nuk e kanë pasur të qartë noterët, si kanë mundur të e bëjnë informimin e drejtë tek palët.

- ✚ E gjetur tjetër në lidhje me Noterët është, se me rastin e përpilimit të Kontratave të shitblerjes, Noterët i kanë bërë ndarje të veçant pronës së përbashkët. Pra, së pari duke i përpiluar dy kontrata të veçanta për seclin bashkëshortë nga një, dhe dyta duke i bërë përpjesëtim pronës së përbashkët. Përpjesëtimi mund të jetë proporcional, por në këtë rast nuk kanë vlejtur masat nga udhëzimi, sepse prona ka qenë sikur të jetë e blerë ndërmjet dy apo më shumë pronarëve të ndryshëm dhe jo nga bashkëshortët.
- ✚ Sa i takon efektit të arritur nga këto masa, është gjetur se për vitin 2016, prej hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi në muajin Mars 2016, janë gjithsejt 597 raste të regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve në të gjitha Komunat e Kosovës. Ky duket të jetë një sukses, por nëse marrim për bazë të dhënat për 10 Komunat e synuara, del që vetëm në Komunën e Ferizajt kemi pasur një rritje të thekësuar, në komunat tjera ka rritje të lehtë, në Fushë Kosovë është tërësisht identike, që nënkupton se nuk ka pasur fare efekt, dhe në Prishtinë ka pasur madje kundër efekt me deri në muajin Maj janë taksuar dyfish me taksën mbi transaksionin.
- ✚ Zbatimi i masave të tilla, por edhe i legjislacionit tjetër ekzistues kërkon më shumë përkushtim institucional dhe shoqëror që të gjejnë zbatim në praktikë. Në të kundërtën ato mbesin vetëm në letër.

10. Konkluzione

Nga analiza e të dhënave në këtë raport të mbledhura nga tereni dhe të përpunuara nga të dhënat statistikore, si dhe duke parë të gjeturat që ndërlidhen me zbatimin në praktikë të legjislacionit në fuqi dhe masave afirmative, mund të vijmë në disa përfundime të dobishme për avacimin e të drejtave të grave në pronë.

Kështu, sikur u pa më lartë masat afirmative janë shumë të dobishme për të shtyrë përpara një çështje që është në shërbim të avancimit të një shtrese marginale apo nxitje të zhvillimit të përgjithëshëm shoqëror. Pra, masat afirmative për të nxitur pjesëmarrjen e grave në pronë, dhe duke tentuar me i thyer “mitet” ekzistuese në kulturën zakonore dhe shoqërinë tonë patriarkale, janë shumë të nevojshme dhe me efekte afatshkurta dhe afatgjata.

Në anën tjetër sikur u pa nga intervistimet e akterëve relevant, zyrtarët publik e të tjerë, ekziston një nivel i mirë i informimit dhe ndërgjegjësimi rreth të drejtave të grave në pronë, por zbatimi praktik i legjislacionit dhe këtij mentaliteti është shumë i kundërt. Pra, ekziston një deklaron publik, sidomos i njerëzve të një shtrese pakasa intelektuale, se të drejtat e grave duhet të zbatohen, përveç se të njihen, megjithatë situata e vlerësuar momentale nga ky raport, por edhe nga shumë mekanizma tjerë nuk tregojnë gjendjen e mirë të zbatimit të këtyre të drejtave.

Nga të dhënat e më sipërme mund të konstatojmë po ashtu se trendi i përfshirjes së grave në të drejtat e tyre pronësore është bukur pozitiv, edhe pse jo i nivelit të kënaqshëm. Në secilën komunë për të cilat janë mbledhur të dhëna, vërejmë se a një rritje të lehtë të pjesëmarrjes së grave në llojet e ndryshme të posedimit apo regjistrimit të pronës. Madje, edhe në rastet kur numri i përgjithshëm i pronave të regjistruara është me i ulët në raport me vitin paraprak, numri i rasteve kur gratë bëhen titullare të pronës në çfarëdo forme është gjithnjë më i lartë se sa në vitin paraprak. Kjo është parë në shumicën e komunave ku kemi vepruar në kuadër projektit, dhe të dhënave që përmbanë ky raport. Përfundim nga dhjetë komunat e mbuluara në këtë raport bëjnë Komuna e Hanit të Elezit dhe Shtërpces.

Po ashtu mund të konstatojmë për zbatimin e masave të tilla afirmative dhe të tjera që mund të vijnë në proces më pastaj, duhen bërë më shumë aktivitete ndërgjegjësues dhe promovuese. Nëse marrim për bazë komunën e Prishtinës, disa veprime të noterëve, jo nivel i lartë i informimit publik për këto masa konkludojmë se duhen më shumë angazhime të tilla. Një shumë e rëndësishme që është vërjetur, po ashtu nga kjo mungesë e promovimit është aktivitete ndërgjegjësuese dhe bashkëbiseduese kanë munguar. Sidomos, shpjegimi i qartë ndaj palëve, në këtë rast nga zyrtarët kadastral dhe noterët, por njëkohësisht edhe zyrtarët për barazi gjinore, për përfitimet që kanë me rastin e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Pra, ata njoftohen vetëm se kanë të drejtë dhe liroheni prej taksës së regjistrimit, por besojmë se shoqëria duhet të ndërgjegjësohet më shumë për përfitimet reale.

Ajo që mund të nxjerret si konstatim e që ka ardhur kryesisht disa Noterë të intervistuar ka të bëjë me ekzistimin e nevojës për të promovuar regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve apo jo. Meqë ligji mbi familjen e njeh këtë drejtë, atëherë kjo duket se një aktivitet i dyfishtë. Por, ky konstatim n'a shpie përsëri deri deri tek supozimi jonë fillestar se legjislacioni ekziston, por mungon zbatimi konkret dhe në praktikë i këtij legjislacioni. Nëse, ligji mbi familjen e njeh të drejtën e gruas në pasurinë e përbashkët, atëherë pse ajo nuk regjistrohet edhe në emër të saj. Kjo nuk ndodhë, andaj është dashur të ndërhyhet me masa të veçanta.

Sa i përket sfidimit të së drejtës së garve në pronë, mbetet edhe çështja e trashëgimisë pronësore nga familja. Duke vepruar në këtë projekt kemi dashur të masim së paku opinionin e të intervistuarëve se çfarë mendojnë për këtë çështje. Sikur është parë, të intervistuarit nuk është se nuk e dinë dhe pranojnë që edhe gratë kanë të drejta të barabarta në pronë dhe pasur të trashëguar. Por, kur janë pyetur se si qëndron situata në familjen e juaj, është parë se me shumë hezitim e kanë pranuar se kjo duhet të zbatohet. Në disa raste janë përgjigjur se nuk e kanë trashëguar ende pasurinë e kështu me radhë.

Dhe ndoshta elementi i fundit që n'a jep një përfundim të rëndësishëm është se ka raste që edhe gratë kur janë bartëse të një pronë të caktuar nuk e kanë bërë regjistrimin e pronës edhe në emër të bashkëshortit. Edhe pse na mungojnë të dhënat nëse prona është fituar gjatë martesës, para saj, apo në formë dhurate e trashëgimie, niveli i përafërtë i burrave dhe grave tregon se ajo që duhet në këtë vend është vetëm ndërhyrjet ligjore. Pra, ligji duhet të caktoj të drejta tërësisht të barabarta, dhe ndoshta detyrime që dalin përtej vullnetit të pacënueshëm sipas legjislacionit civil, në mënyrë që bilanci gjinor të jetë i pasfiduar në pronë.

11. Rekomandime

Në bazë të gjitha këtyre të gjeturave dhe konstatimeve që dalin nga një proces i vlerësimit të zbatimit të legjislacionit dhe matjes së opinionit publikut për çështjet gjinore, mund të japim disa rekomandime për të e përmirësuar të drejtat e grave në kuptim ligjor dhe zbatim praktik.

1. Masat afirmative janë të dobishme për shoqëritë që synojnë zhvillimin më të shpejtë, dhe pikërisht për këtë rekomandojmë që masat aktuale të vazhdojnë edhe për një periudhë të caktuar.
2. Rekomandojmë po ashtu që para se këto masa të vazhdojnë të sqarohet edhe më tutje nga niveli komunal se cila është taksa apo tarifa e regjistrimit të pronës dhe që të kërkohej që ajo të mënjanohej. Meqë sikur u pa kishte shumë paqartësi rreth zbatimit të këtyre masave në disa prej komunave.
3. Masat afirmative të kësaj natyre të zgjerohen edhe me taksat tjera, përkatësisht me taksën mbi transaksionin. Meqë disa komuna vetëm e zbatojnë këtë, ku nuk zbatohet taksa e transaksionit me rastin e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve.
4. Rekomandojmë që të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatim të këtyre masave të jenë shumë më vigjilente, shumë më të përkushtuara, dhe shumë më aktive në çështjet pronësore dhe përfshirjen gjinore në posedimin e pronës së përbashkët.
5. Rekomandojmë që Agjencia për Barazi Gjinore dhe Agjencia Kadastrale të bëjnë më shumë në promovimin e këtyre masave apo edhe masave tjera afirmative që mund të vijnë, në mënyrë që sa më shumë të ndërgjegjësohet opinioni i gjerë lidhur me mundësitë dhe përfitimet nga këto masa.
6. Rekomandojmë që ligji për familjen të ndryshohet me qëllim të bërjes së detyrues të regjistrimit të pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve. Meqë kjo është sygjyeruar edhe nga disa noterë gjatë intervistimit, por poashtu meqë ligji aktual mbi familjen njih të drejtën e të dy bashkëshortëve në posedimin dhe shfrytëzimin e pronës së krijuar gjatë martesës, atëherë letësisht kjo mund të bëhet e detyrueshme edhe me ligj.

12. Referencat

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji i Familjes i Kosovës
- Ligji për Trashëgimi i Kosovës
- Ligji për Noteri
- Ligji për Barazi Gjinore
- Konventa CEDAË
- Konventa për të Drejta të Njeriut
- Programi për zhvillim ekonomik të gruas
- Raporti i EULEX-it mbi të drejtat pronësore të Grave
- Udhëzimi Administrativ për masat affirmative